



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

GJUHA DISKRIMINUESE NË TEKSTET SHKOLLORE

ANALIZË E TEKSTEVE
SHKOLLORE TË NIVELIT TË
MESËM TË LARTË NË KOSOVË

PRISHTINË, NËNTOR 2017

E drejta autoriale © 2017 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS).

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdolloj mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjimi, incizimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të YIHR KS-së.

Përmbajtja e Hulumtimit “Gjuha diskriminuuese në tekstet shkollore” është përgjegjësi e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS) dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, Qeverisë Amerikane apo Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA





YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

GJUHA DISKRIMINUESE NË TEKSTET SHKOLLORE

ANALIZË E TEKSTEVE
SHKOLLORE TË NIVELIT
TË MESËM TË LARTË
NË KOSOVË

PRISHTINË, NËNTOR 2017



EKIPI HULUMTUES

Trina Binaku, Vesa Deva, Bjeshka Guri, Albert Selimi, Ramadan Sokoli

AUTORË TË ANALIZËS

Trina Binaku, Vesa Deva, Bjeshka Guri, Albert Selimi, Ramadan Sokoli, Veton Sylhasi, Marigona Shabiu

BOTUAR NGA

Youth Initiative for Human Rights - Kosovo (YIHR KS)

FALENDERIM

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë, dëshiron të falënderojë USAID/ATRC që përmes Programit për Angazhim dhe Barazi (E4E) ka ofruar ndihmën financiare për realizimin e kësaj analize.

Falënderojmë të rinjtë që morën pjesë në punëtoritë e organizuara dhe plotësuan pyetësorët, gjë që bëri të mundur që rezultatet e analizës së këtyre pyetësorëve të plotësojnë këtë studim dhe të kontribuojnë në përfundimet e arritura. Gjithashtu, falënderojmë dr.Vjollca Krasniqi dhe Njomza Haxhibeqirin për kontributin e tyre në realizimin e punëtorive me nxënësit e shkollave të mesme.



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	04
1 HYRJA	06
2 METODOLOGJIA	07
3 TË GJETURAT KRYESORE	09
3.1 Tekstet mësimore në raport me standardet e të drejtave të njeriut	09
3.2 Njohuritë e nxënësve të shkollave të mesme të larta mbi aspekte të përgjithshme e të veçanta të të drejtave të njeriut	22
4 PËRFUNDIMI	29
5 REKOMANDIMET	33
6 BIBLIOGRAFIA	36
7 SHTOJCAT	37
7.1 Tekstet shkollore të shqyrtuara	37
7.2 Lista e formulimeve me gjuhë diskriminuese	38
7.3 Pyetësi për nxënësit	55

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo analizë e bërë në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e të rinjve në edukim gjithëpërfshirës dhe të drejtat e njeriut”, ka analizuar tekstet mësimore të shkollave të mesme të larta rreth përdorimit të gjuhës diskriminuese. Po ashtu, projekti ka hulumtuar njohuritë e të rinjve për aspektet e të drejtave të njeriut në vështrim të arsimit që marrin. Qëllimi i kësaj analize është që të zbulohet behët e ditur se deri në çfarë mase tekstet mësimore të shkollës së mesme të lartë janë në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut, dhe deri në çfarë mase e në çfarë cilësie procesi i mësimdhënies dhe i të nxënit në këtë nivel i reflekton këto parime.

Analiza e përmbajtjes së teksteve mësimore ka përfshirë lëndët: Biologjia, Edukata Qytetare, Histori, Psikologji dhe Sociologji. Ka analizuar këto tekste përmes këtyre pesë parametrave: 1) Gjininë dhe Seksualitetin, 2) Kombi, Etnia, ‘Raca’, 3) Të Drejtat e Njeriut dhe Qytetaria; 4) Trupi dhe Aftësia; dhe 5) Diversiteti dhe barazia shoqërore. Analiza tregon se tekstet shkollore janë përplot me formulime që përmbajnë gjuhë diskriminuese e përjashtuese. Një sistemim i këtyre gjetjeve nëpër kategori sipas bazës së diskriminimit apo përjashtimit ka nxjerrë në pah se më së shpeshti tekstet shkollore janë të ngarkuara me gjuhë diskriminuese në këndvështrim të përkatësisë etnike, përkatësisë gjinore, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe përjashtimit social. Megjithatë nuk mungon gjuha diskriminuese në këndvështrim të aftësisë, statusit ekonomik-shoqëror si dhe përdorimi i gjuhës së dhunshme. Më saktësisht, është konstatuar se ka:

- Njëanshmëri etnike, mospërfshirje etnike dhe gjuhë e urrejtjes etnike;
- Përdorim të gabuar të nocionit “kombi” kur shqyrtohen aspektet e shtetit;
- Stigmatizim të formave të ndryshme të familjes; grupeve shoqërore jo shumicë, të varfërve, komuniteteve jo heteroseksuale, të moshuarve, grave, njerëzve që jetojnë në fshat, personave me aftësi të kufizuara
- Përkufizim i orientimeve seksuale dhe identiteteve gjinore si devijime;
- Portretizim ofendues mbi bazën e aftësive të kufizuara; të moshës, profesionit, vendbanimit, përkatësisë etnike dhe religjionit, orientimit seksual dhe identitet gjinor.

- Shembuj të papërshtatshëm e lidhje jorelevante që forcojnë stereotipe, paragjykime, dehumanizim dhe dhunë simbolike ndaj kategorive shoqërore të caktuara
- Pyetje e detyra sugjестive e tendencioze në relacion të gjinisë.
- Pasaktësi dhe mungesë të referencave për informacionin e ofruar dhe burimeve shtesë shkencore.

Në anën tjetër, analiza e rezultateve të pyetësorëve të plotësuar nga të rinjtë tregon se ka një dallim të madh në mes të përgjigjeve të dhëna para dhe pas punëtorisë për aspektet e të drejtave të njeriut. Pas punëtorisë nxënësit kanë treguar njohuri të shtuara për aspektet e të drejtave të njeriut. Nga kjo mund të kuptojmë se informimi në mënyrë të duhur i aspekteve të ndryshme të të drejtave të njeriut, ka ndikim në krijimin e njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve të nxënësit. Punëtoritë kanë trajtuar tema specifike të të drejtave të njeriut si: orientimi seksual dhe identiteti gjinor, drejtësia tranzicionale, barazia gjinore, etj. Kjo analizë ka evidentuar se nxënësit nuk i mësojnë këto tema në shkollë.

Nga analiza janë nxjerrë rekomandime, për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), shkollat, shtëpitë botuese, shoqërinë civile dhe prindërit. Ato lidhen me intervenimet në sistem që të sigurohet cilësi në procesin e botimit të teksteve shkollore përmes: funksionalizimit të komisionit për rishikimin e teksteve shkollore, si dhe recensionit të secilit tekst shkollor, ngritja e standardeve për përzgjedhjen e autorëve dhe përmbajtjes së teksteve shkollore, hapjes së procesit të hartimit dhe botimit të teksteve shkollore, rishikimit të rregullativës ligjore dhe ngritjes së kapaciteteve të autorëve të teksteve, dhe shtëpive botuese.

Shtëpive botuese u rekomandohet që të ndjekin zhvillimet në arsim, në politika e praktika arsimore. Po ashtu ato duhet të krijojnë ekipe kompetente të autorëve dhe profesionistëve të profileve të ndryshme që të punojnë bashkërisht në hartimin e teksteve shkollore.

Mësimdhënësve u sugjerohet që në mënyrë kritike t'i vlerësojnë të gjitha tekstet shkollore që i përdorin dhe të tregojnë ndjeshmëri në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut. Po ashtu, u sugjerohet që të përdorin metoda që nxisin të menduarit kritik dhe zhvillimin e autonomisë së të menduarit të nxënësit.

Prindërit duhet të bashkëpunojnë me mësimdhënësit dhe me nxënësit për të zgjidhur problemet me përmbajtjet diskriminuese. Ata/ato, po ashtu duhet të shfrytëzojnë grupet formale të prindërve, por edhe grupet joformale, për të bërë presion në sistemin e edukimit që të eliminohej përmbajtjet diskriminuese dhe gabimet e tjera nga tekstet shkollore.

1. HYRJJE

Edukimi cilësor i të rinjve është parakusht për një shoqëri gjithëpërfshirëse. Përmes edukimit, të rinjtë pajisen me njohuri, shkathtësi, vlera e qëndrime, që janë të domosdoshme për një jetë në bashkësi, ku secili anëtar e ndien veten të sigurt e me mundësi të barabarta, ku çmohet diversiteti dhe promovohet respekti dhe solidariteti. Edhe pse ka shumë forma të edukimit joformal (trajnime, punëtori, qendra rinore etj.) megjithatë, janë shkollat si mjedise formale të arsimit, që kanë rolin kryesor në pajisjen e fëmijëve dhe të rinjve me informata dhe kompetencat e lartpërmendura. Arsimiti përmes qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, mund edukoj qytetarë të ndërgjegjshëm e aktivë.

Sistemi i arsimit në Kosovë nuk i mundëson të rinjve të zhvillojnë kapacitete për të vlerësuar në mënyrë kritike realitetin socio-ekonomik e politik që i rrethon. Ky sistem, jo vetëm që nuk u ofron atyre cilësi të informatave e përmbajtjeve mësimore, por as nuk nxit diskutime apo vlerësim kritik lidhur me informacionin që marrin. Për më tepër, sistemi i arsimit ende është larg gjithëpërfshirjes. Tekstet shkollore përmbajnë gjuhë diskriminuese dhe përjashtuese ndaj grupeve të caktuara sociale të marginalizuara në Kosovë.

Shqetësimet e qytetarëve, njohësve të arsimit dhe aktivistëve të organizatës Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë, për cilësinë e ulët të arsimit dhe rastet e gjuhës diskriminuese në tekstet shkollore, ishin nxitje për të analizuar tekstet shkollore. Kjo analizë është veçanërisht e rëndësishme sepse tekstet shkollore vazhdojnë të jenë burimet parësore, e shpesh edhe të vetmet, për nxënësit në procesin e të nxënimit. Kështu, përmbajtja e teksteve shkollore është një hapësirë ku paragjykimet tashmë ekzistuese përforcohen dhe institucionalizohen me anë të informatave të pasakta dhe të papërditësuara, ne ndikim të dëmshëm në thellimin e ndarjes dhe izolimit të grupeve të caktuara shoqërore në Kosovë.

2. METODOLOGJIA

Qëllimi i analizës ishte që të bëhet e ditur se deri në çfarë mase tekstet mësimore të shkollës së mesme të lartë janë në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut, dhe deri në çfarë mase e në çfarë cilësie procesi i mësimdhënies dhe i të nxënies në këtë nivel i përfshin këto parime.

Në kuadër të kësaj analize janë ngritur këto pyetje hulumtuese:

- Sa janë tekstet mësimore në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe a ka raste të përdorimit të gjuhës diskriminuese e përjashtuese?
- Cilat janë njohuritë e nxënësve të shkollave të mesme të larta lidhur me aspekte të përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe me aspekte të veçanta të të drejtave të pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara?

Analiza ka shfrytëzuar një kombinim të metodave cilësore dhe sasore dhe është zhvilluar në dy drejtime. Në njërin anë janë rishikuar tekstet mësimore të shkollave të mesme të larta në këndvështrim të përdorimit të gjuhës diskriminuese e mospërfshirëse, si dhe pasaktësive shkencore e sociale që vijnë nga të menduarit e bazuar në stereotipe. Janë përzgjedhur tekstet shkollore të atyre lëndëve që në mënyrë më të drejtpërdrejtë merren me aspektet psiko-fizike dhe sociale të njeriut: Edukata Qytetare, Historia, Biologjia, Sociologjia dhe Psikologjia. Mostra ka përfshirë gjithsej 22 tekste shkollore të këtyre lëndëve, për klasat 10, 11 e 12, në drejtimet e ndryshme të gjimnazeve dhe shkollave profesionale. Tabela e teksteve të rishikuara është dhënë në shtojcën 1. Secili tekst shkollor është audituar nga një hulumtues. Të gjeturat i janë dorëzuar një hulumtuesi tjetër që e ka bërë validimin e këtyre të gjeturave përmes një procesi të rishikimit dhe analizës së tekstit.

Në anën tjetër, përmes thirrjes së hapur për aplikime, janë përzgjedhur mbi 50 të rinj të shkollave të mesme të larta për të marrë pjesë në punëtori të organizuara me qëllim që të rritet pjesëmarrja e të rinjve në procese që lidhen me të drejtat e njeriut dhe të zhvillohen kapacitetet e tyre në fushën e antidiskriminimit, legjislacionit dhe praktikave të të drejtave të njeriut.



Të rinjtë janë përzgjedhur nga 6 rajone të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Rahovec, Ferizaj dhe Prizren. Programi i edukimit joformal i ofruar përmes punëtorive ka trajtuar temat si: të drejtat e njeriut, drejtësia tranzicionale, gjinia e seksualiteti dhe gjuha diskriminuese. Për më tepër vetë të rinjtë pjesëmarrës në punëtori — përmes modulit të gjuhës diskriminuese — kanë identifikuar rastet e gjuhës diskriminuese në tekstet shkollore, duke bërë ndërlidhjen me rishikimin e teksteve shkollore nga ekipi hulumtues. Lidhur me këto punëtori, është përgatitur një pyetësor. Nxënësit e kanë plotësuar pyetësorin para se të nisnin punëtoritë. Pyetësori ka përmbajtur pyetje që lidhen me aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut, në veçanti gjininë, seksin, drejtësinë tranzicionale, udhëheqjen dhe gjuhën diskriminuese. Pas punëtorive, të rinjtë pjesëmarrës sërish e kanë plotësuar pyetësorin e njëjtë. Qëllimi ka qenë të shihet ndryshimi eventual i opinioneve e qëndrimeve të të rinjve pas një programi të edukimit.

Të dhënat e mbledhura për gjuhën diskriminuese e përjashtuese në tekstet shkollore janë sistemuar në një bazë të të dhënave të punuar në Excel, duke bërë një kodim të të dhënave ashtu që të mund të analizohen: lënda mësimore, klasa apo niveli i shkollimit, drejtimi shkollor, faqja dhe baza e diskriminimit. Të dhënat nga pyetësorët e plotësuar janë përpunuar në SPSS (Statistical Package for the Social Sciences), një pako e specializuar për analizën e të dhënave statistikore.

Analiza ka përfituar nga vështrimi në vazhdimësi i legjisllacionit në fuqi dhe politikave të arsimit. Ekipi hulumtues pashmangshëm ka marrë në shqyrtim edhe këto aspekte. Për më shumë, mbi këtë bazë rekomandojmë studime në vazhdimësi për marrëdhënien në mes të aspekteve strukturore të arsimit, teksteve shkollore, dhe efekteve të tyre në praktikën dhe pedagogjinë në mësimdhënie.

3. TË GJETURAT KRYESORE

3.1 CILËSIA E TEKSTEVE MËSIMORE NË RAPORT ME STANDARDET E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në tekstet shkollore të analizuara, janë gjetur mbi 100 formulime që përmbajnë gjuhë diskriminuese e përjashtuese. Kategorizimi i gjetjeve sipas bazës së diskriminimit apo përjashtimit tregon se më së shpeshti tekstet shkollore përmbajnë gjuhë diskriminuese në bazë të gjinisë, etnisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe përjashtimit social. Gjithashtu nuk mungon as gjuha diskriminuese në bazë të aftësive të kufizuara, statusit ekonomik-shoqëror si dhe përdorimi i gjuhës së dhunshme.

Asnjë nga tekstet shkollore të shqyrtuara nuk është i liruar nga gjuha diskriminuese. Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë e teksteve shkollore të lëndëve të caktuara me llojin e diskriminimit që e hasim në to. Kështu, tendenca është që tekstet shkollore të Historisë të jenë të ngarkuara në radhë të parë me gjuhë diskriminuese dhe përjashtuese mbi bazën e etnisë; tekstet shkollore të Biologjisë kanë më shumë gjuhë diskriminuese mbi bazën e aftësive të kufizuara dhe gjinisë; në tekstet e Edukatës Qytetare më së shumti ka raste të diskriminimit mbi bazën e etnisë, të gjinisë, orientimit seksual e identitetit gjinor; te tekstet e Psikologjisë dominojnë rastet e gjuhës diskriminuese mbi bazën e gjinisë; edhe në tekstet e Sociologjisë, rastet e gjuhës diskriminuese mbi bazën e gjinisë janë në numër më të madh, por ka edhe mbi orientimin seksual, identitetin gjinor dhe ndarjen klasore.

NJËANSHMËRI, MOSPËRFSHIRJE DHE GJUHË QË NXIT URREJTJE ETNIKE

Në tekstet mësimore shpesh formulimet e gjetura janë ekzagjerime të rolit, cilësive dhe pasurisë së një populli apo etnie në krahasim me popujt apo etnitë tjera. Tekstet e historisë sforcojnë një përfaqësim simbolik të kombit përmes ndarjes në "Ne" dhe "Tjetri". E para, "Ne" vjen të valorizojë kombin dhe nxitë ndjenjën e përkatësisë kombëtare, dhe e dyta ka të bëjë me ndërtimin e imazhit të "Tjetrit", respektivisht armikut të kombit. Kjo shihet në këto dy raste:

” “Shpirti lirishtës i popullit shqiptar nuk u thye as pas këtyre përpjekjeve të sukseshme të nivelit Ballkanik”¹
“Në Ballkanin Perëndimor, krahas shqiptarëve autoktonë, gjatë historisë u vendosën edhe popullsi të tjera për të jetuar.”²

Kështu, nacionalizmi territorial përshkon mësimin e historisë. Më tutje në mësimet e historisë, “tokat shqiptare” definoohen si hapësirë civilizuese përkrahshi dyndjeve në Ballkan, përmes gjuhës diskriminuese, që cilëson popujt e tjerë si “primitivë” dhe kështu me konotacion negativ. Kjo më së miri ilustron me këtë pjesë nga teksti i historisë:

” “ata ende jetonin si në kohën e bashkësisë primitive, por gradualisht filluan të inkorporohen në rrjedhat kulturore që kishin kultivuar popujt vendas shekuj me radhë.”³

Për më tepër kjo anshmëri ushqehet edhe me ekzagjerim në aspekt të shifrave e fakteve nga historia e re e Kosovës. Kështu, në tri tekste të ndryshme të Historisë, lidhur me luftën e fundit në Kosovë thuhet:

” «Vetëm gjatë muajve të bombardimit të forcave ajrore të NATO-s ushtria serbe vrau rreth 15.000 shqiptarë...”⁴

Asnjë nga këto tekste nuk e tregon burimin e informatës dhe nuk përmend numrin e të vrarëve që u përkasin etnive tjera. Ky fakt dëshmon përjashtimin sistematik të të gjithë viktimave që nuk i përkasin etnisë “shqiptare” dhe njëkohësisht forcon idenë e cilësimit të tyre vetëm si agresorë. Kjo përmbajtje sforcon ndarjen në “viktima” dhe “agresorë” dhe kufizon hapësirën për kërkim të së vërtetës.

Raste të tjera të mospërfshirjes etnike mund të gjejmë në tekstet e Edukatës Qytetare. Aty thuhet:

” “Qeveria e Kosovës është qeveri e koalicionit në të cilën marrin pjesë PDK, LDK, lista serbe “Srpska” dhe partitë e minoriteteve të tjera që jetojnë në Kosovë”⁵.

Në këtë libër, te njësia mbi partitë politike, paraqitet fotografia me logot e partive politike shqiptare, duke përjashtuar partitë joshqiptare.⁶ Për më

1 Bicaj, Isa dhe Arbër Salihu. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f.144, p.2)

2 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f.82, p.4)

3 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f.113, p.7)

4 Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 207, p. 1), Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 221, p. 4), Bicaj, Isa dhe Isuf Ahmeti. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 202, p. 5)

5 Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f.14, p. 2)

6 E njëjta paraqitje vizuale e logove të partive politike shqiptare bëhet edhe në librin *Edukata Qytetare 10*, në të cilin nuk ceket drejtimi (f. 17).

tepër, edhe po të ishin përfshirë simbolet e partive të komuniteteve etnike, ekspozimi i simboleve të partive politike është i panevojshëm në tekstet shkollore.

Autorët e teksteve shkollore përdorin gjuhë që nxit urrejtje etnike. Një shembull i gjuhës së këtillë është përkrahimi i ngjarjeve historike duke përdorur fjalë të ashpra, si në rastin e tekstit *Historia 10*.⁷ Aty, autorët duke iu referuar luftës së fundit në Kosovë, veprimet e forcave serbe i përshkruajnë me fraza si

“...skenat e llahtarshme të barbarisë së eskadronëve gjakatare...”⁸

duke nxitur të lexuesit e rinj neveri e urrejtje, e kundërta e asaj që promovon drejtësinë tranzicionale. Rast i ngjashëm është edhe në tekstin *Historia 11* për gjimnazin gjuhësor, ku duke iu referuar veprimeve të “forcave zerviste” mbi popullsinë e Çamërisë, thuhet:

“Ata në qershor e gusht të vitit 1944, torturuan, therën e vranë me mijëra burra, çnderuan me qindra gra dhe të reja.»⁹

Nuk mungojnë as termat ofendues për t’iu referuar komuniteteve të ndryshme etnike. Përdorimi i tyre në mjedise formale arsimore, përmes teksteve shkollore është diskriminues. Kështu, në tekstin shkollor *Historia 11* për gjimnazin e përgjithshëm, përdoret termi “jevgj” për romët dhe “çifut” për hebrenjtë. Madje, përdoret një gjuhë me premisa relativizimi për “jevgjit” duke hamendësuar se «për numrin e tyre nuk mund të flitet me saktësi, por, nuk duhet të jetë i madh»¹⁰ dhe më tutje duke pretenduar se “...trajtimi i tyre, në këto troje, nuk ka qenë i keq thujtë asnjëherë gjatë historisë”.¹¹ Tekstet shkollore të historisë janë të ngarkuara dhe me përshkrime të ngjarjeve e figurave historike, përmes sentimentalizmave që i kthejnë këto tekste në tekste romantike nacionaliste për kombin. Për shembull, shqiptarët reprezentohen me “besim të patundur në forcat e veta”¹², apo se si Skënderbeu vdiq “i mbuluar me lavdi të përjetshme.”¹³

7 Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 205, p. 4)

8 Shih edhe: Gashi, Shkëlzen. *Historia e Kosovës – në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni*, 2016 (f.112, p. 2)

9 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 210, p. 4)

10 Bajraktari, Jusuf dhe Isa Bicaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2006 (f. 83, p. 4)

11 Po aty.

12 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015. (f. 177, p. 3)

13 Po aty (f. 179, p. 1)

KOMBI DHE KOMBËTARJA KARSHI SHTETIT DHE SHTETËRORES

Në vështrim të subjektit të kësaj analize mund të duket si i kotë diskutimi për kombin e shtetin, respektivisht për kombëtaren dhe shtetëroren. Mirëpo për shumëkë këto nocione janë shumë të rëndësishme, në vështrim të ndjenjës së rehatisë apo sikletit që përcillet me to. Për shkak të një ndjeshmërie të tillë, përdorimi i gabuar i këtyre nocioneve në tekste shkollore, mund t'u japë formulimeve nuanca të gjuhës diskriminuese. Në tekstet shkollore të shkollave të mesme të larta në Kosovë, ka mjaft raste kur diçka që ka të bëjë me Kosovën të pasqyrohet përmes kombit apo kombëtares.

Të kujtojmë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 3, pika 1 përcakton: "Republika e Kosovës është shoqëri shumë etnike..." .Edukata Qytetare 10 për shkollat profesionale , derisa përshkruan disa nivele të komunitetit, Kosovës i referohet si komunitet kombëtar. Në faqen 42, ku elaborojnë më thellë komunitetin kombëtar, autorët kufizohen te kultura shqiptare si pjesë e komunitetit kombëtar, duke lënë anash të gjitha grupet etnike tjera që jetojnë në Kosovë. Është e qartë se kjo është gjuhë përjashtuese dhe mund të merret si tendencë për supremaci të një kombi mbi të tjerët, brenda një vendi apo shteti shumë-etnik. Në tekstin shkollor të përmendur më lartë ka edhe formulime tjera të këtilla. Kështu, shkruhet:

”

“P.Sh., ekspertët ligjorë argumentojnë se shprehja e ideve të caktuara është e dëmshme për publikun, ajo mund të sjellë rrezikim të interesave kombëtare”.¹⁴

Edhe në tekstin tjetër shkollor të autorëve të njëjtë, hasen formulime të këtilla, si:

”

“Qeveria mbron popullin nga armiqtë e kombit”.¹⁵

Për të shmangur gjuhën përjashtuese, mund të përdoreshin fjalët “interesa të përgjithshme” apo “interesa të shoqërisë” në rastin e parë, respektivisht “armiqtë e vendit” në rastin e dytë.

¹⁴ Po aty, (f. 66, p. 4)

¹⁵ Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 6, p. 3)

PARAGJYKIMET DHE STEREOTIPET GJINORE

Gjinia është shumë e përfaqësuar në tekstet shkollore, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes shtjellimit të aspekteve biologjike, roleve gjinore, aftësive, etj., e ku në mënyrë indirekte, përmes shfrytëzimit të këtyre aspekteve për të shtjelluar tema të tjera shoqërore.

Fatkeqësisht, gjatë shqyrtimit të teksteve shkollore janë gjetur mjaft raste të përdorimit të gjuhës diskriminuese në aspekt të gjinisë. Spektri i këtyre rasteve fillon me paragjykimet dhe stereotipet gjinore dhe përfundon me etiketimin e grave mbi bazën e karakteristikave të tyre fizike e psikike.

Gratë dhe fëmijët paraqiten si grupe të cenueshme shoqërore, viktimat dhe kështu bëhen subjekte pa fuqi veprimi. Citati në vijim sugjeron këtë

”

”Shumë prej tyre (nëna e fëmijë) që kanë përjetuar bombardimin më vonë kanë vdekur nga leukemia dhe sëmundje të tjera malinje.»¹⁶

Në tekstet e psikologjisë kur flitet për karakteristikat sociale dhe personalitetin e njerëzve mbi bazë gjinie autorët u referohen si meshkuj e femra e jo si burra e gra, duke e anashkaluar statusin social. Kjo ndikon që nxënësit të mos dinë të dallojnë seksin dhe gjininë dhe kjo është vërtetuar në këtë analizë përmes rezultateve të pyetësorëve me nxënësit pjesëmarrës në punëtori.

Ende në këto tekste burrat dhe gratë mbërthehen brenda roleve të tyre gjinore dhe sjelljeve “tipike”, tradicionale. Në këto tekste tregohet se si “Loja më e këndshme e vajzave të vogla është ajo me kukulla”, apo se si “Meshkujt priren të luajnë me kamionë, aeroplanë dhe blloqe, ndërsa vajzat kryesisht luajnë me veshje, kafshë plastike të fryra, etj.” Në një rast tjetër, duke shtjelluar çështje të historisë së artit, forcohen stereotipet gjinore, përmes “...figura e intelektualit apo bukuria femërore etj.” Përshkrimin me doza të larta të sentimentalizmit: “...akti burrëror i një minatori” e hasim në dy tekste të ndryshme të historisë, të shkruara nga autorë të ndryshëm: Historia 10 për gjimnazin matematikë dhe informatikë, dhe gjimnazin e shkencave natyrore, si dhe Historia 11 për gjimnazin e gjuhëve. Autorët me lehtësi do të mund të zëvendësonin përshkrimin “burrëror” me “human” për tekst me ndjeshmëri dhe perspektivë gjinore.

¹⁶ Berisha, Ahmet, Ismet Bajraktari, Fetah Halili dhe Agim Gashi. *Biologjia* 12. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013 (f.131, p.4)

Kategorizimi midis gjinive është tendencë e autorëve të teksteve të psikologjisë. Kjo ndarje sugjerohet të mbështetet në disa studime e teori (burimet e të cilave nuk paraqiten në tekstet shkollore), e të cilat praktika janë hedhur poshtë si të pavërteta. Studiuesi Regan McNeill, pohon se “struktura e trurit nuk lidhet specifikisht me seksin”. Megjithatë, në tekstin Psikologjia 11 thuhet se

“...të dy trurët janë të lidhur në mënyrë të ndryshme: truri i mashkullit për të bërë dhe ai i femrës për të folur.”¹⁷, dhe më tutje se “...truri i diferencuar si mashkullor e ka më të lehtë të përballet me shumë detyra, si për shembull të folurit gjatë ndërtimit të diçkasë».”¹⁸

Mbi këtë bazë bëhen edhe dallimet në funksionin social, emocional dhe kognitiv. Kështu, sipas një paraqitjeje tabelore në faqen 82, gratë rëndom janë: të kujdesshme, miqësore, të hapura, përfshirëse në agresivitet verbal, anksioze e depresive, dhe të afta të fshehin emocionet. Burrat, në anën tjetër përshkruhen si: garues dhe dominantë, ngulmues, kryes të shumicës së krimeve (veçanërisht krimeve seksuale), që nuk kanë frikë nga rreziqet, që përfshihen në agresivitet fizik, dhe që kanë vetëbesim të lartë. Në po të njëjtin tekst, në faqen vijuese, paraqitet një tabelë tjetër, kësaj radhe lidhur me dallimet gjinore në zgjedhjen e partnerëve dhe sjelljen seksuale. Aty thuhet se gratë rëndom: parapëlqejnë një partner më të moshuar, me të ardhura më të larta e me karakter të mirë; ndjehen të kërcënuara më shumë nga pabesia emocionale; dhe se e kufizojnë marrëdhënien seksuale te partnerët potencialisht afatgjatë. Në anën tjetër, burrat rëndom: parapëlqejnë një partnere më të re, që është fizikisht atraktive e me aftësi të mira amvisërie; ndihen të kërcënuar më shumë nga pabesia seksuale; janë komodë me marrëdhëniet seksuale të rastësishme për veten e tyre; janë xhelozë për sa i përket seksualitetit dhe priren të kontrollojnë partnerët e tyre.

Kështu teksti i Psikologjisë sforcon stereotipet dhe paragjykimet gjinore dhe seksizmin. Këto vërehen në ekstraktet në vijim:

“Për shembull, në SHBA sot, një femër (ose një mashkull) që është e ndjeshme ndaj të tjerëve, e kujdesshme dhe shprehëse e emocioneve (tradicionalisht trajta femërore) dhe është gjithashtu e fortë, e pavarur dhe garuese (trajta mashkullore) do të konsiderohej të ishte androgjene.”¹⁹

17 Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 80, p. 2)

18 Po aty (f. 80, p. 3)

19 Psikologjia Klasa 11.

”

“Për shembull, vetëm pse pranohet që, si mesatare, femrat kujdesen për fëmijët më shumë se meshkujt, nuk nënkupton automatikisht që një mashkull i caktuar të jetë më pak i kujdesshëm se sa shumica e femrave. Në fakt, ai mashkull i caktuar mund t’i dojë shumë fëmijët dhe të shfrytëzoj çdo mundësi që i jepet të luajë me ta. Kjo nuk e bënë atë mashkull femër, por sugjeron që ai mashkull ka një dimension ‘femëror’ në personalitetin e tij.”²⁰

“femrat duket se binden më lehtë sesa meshkujt.”²¹

“Për shembull, ne dimë që cikli menstrual mund të ndikojë performancën matematike dhe verbale të femrave. Kjo na sugjeron që dallimi në performancë në rezultatet e matematikës dhe ato verbale midis femrave dhe meshkujve është i lidhur me seksin.»²²

“Më tej, meshkujt janë më të aftë në zhvillimin e fjalorit (për shembull, zhargoni masiv dhe terminologjia teknike që krijohet nga meshkujt), ndërsa femrat janë më të afta në përdorimin e fjalorit që kanë në dispozicion.”²³

Ky test shkon edhe më larg duke kërkuar nga nxënësit të përbrendësojnë seksizmin dhe stereotipet gjinore duke pyetur ata:

”

“A mendoni ju se në shoqërinë tonë ka dallime të mëdha midis meshkujve dhe femrave përsa u përket aftësive të tyre psikike?”²⁴

Dhe kështu duke paragjykuar se aftësitë psikike kanë për bazë dallimet e seksit, teksti i Psikologjisë sforcon përparësinë dhe dominimin e burrave ndaj grave. Përgjithësisht, ky tekst shkollor përçon mizogjininë, pengon mendimin kritik për barazi gjinore.

Një formë e shprehur e gjuhës diskriminuese në tekstet shkollore të Sociologjisë shihet e ndërlidhur me statusin ekonomik-social të gruas. Në tekstet shkollore të shqyrtuara janë gjetur formulime që e lidhin rënien e natalitetit dhe rirpodhimin e popullsisë me “...pozitën më të mirë ekonomike të gruas”²⁵ apo me “...shkallën e arsimimit të femrave”.²⁶ Madje, disa

20 Po aty.

21 Po aty.

22 Po aty.

23 Po aty.

24 Po aty.

25 Berisha, Ahmet, Ismet Bajraktari, Fetah Halili dhe Agim Gashi. *Biologjia* 12. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013 (f. 67, p. 1)

26 Berishaj, Anton dhe Ibrahim Berisha. *Sociologjia* 12 e 13. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012 (f. 101, p. 1)

formulime e dëshmojnë bindjen e autorëve se femra dhe maskulli nuk janë të njëjtë. Kështu është gjetur një formulim që tregon se një familje mund të jetë “kushtimisht” matriarkale. Aty thuhet:

” «Në shoqëritë bashkëkohore, megjithatë, disa familje mund t'i vlerësojmë si matriarkale - pas vdekjes së burrit apo shkurorëzimit, nëse fëmijët i përkasin nënës.»²⁷

Në një formulim tjetër në tekstin shkollor të përmendur më lart Psikologjia 11, autorët i nxisin nxënësit të mendojnë për proceset shoqërore me shtrembërim gjinor përmes pyetjes “Çfarë pasojash ka për shoqërinë përkushtimi i femrave ndaj karrierës?»²⁸ Kjo pyetje sugjeron se gratë të cilat zgjedhin karrierën dhe jo burrat lënë pasoja në shoqëri.

STIGMATIZIMI I FORMAVE TË NDRYSHME TË FAMILJES

Tekstet shkollore, në shqyrtimin e koncepteve të familjes përdorin një qasje të kufizuar të familjes që tkurret në “...krijohet me martesë mes burrit dhe gruas, në të cilën lindin fëmijët...”²⁹ Rrjedhimisht, ndër veçoritë universale të familjes, e para që përmendet është “që mbështetet në lidhje heteroseksuale, në të cilën gratë dhe burrat plotësojnë nevojat seksuale, shpirtërore, morale dhe estetike dhe sigurojnë riprodhimin e shoqërisë me lindjen e pasardhësve».³⁰ Definimi i tillë në tekstin shkollor të sociologjisë është vazhdim i qasjes së njëjtë, të bazuar në heteronormativitet, që haset në tekstin shkollor Edukata Qytetare 9, ku duke e trajtuar “për nga kompaktësia e strukturës dhe e funksionit të saj”, “familje e plotë dhe e harmonishme” konsiderohet familja “...e përbërë prej dy prindërve, fëmijëve të tyre dhe në të cilën nuk manifestohen probleme”.³¹ Përkufizimet e këtilla përjashtojnë familjet me një prind, familjet që në përbërje kanë gjyshërit apo anëtarë të tjerë, familjet që përbëhen nga partnerët homoseksualë, etj. Kësisoj, këto familje jashtë “kallëpit” të përkufizimit, mbesin të stigmatizuara “si jo të plota apo të çrregulluara”.

27 Po aty (f. 105, p. 3)

28 Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 85, p. 4)

29 Berishaj, Anton dhe Ibrahim Berisha. *Sociologjia 12 e 13*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012 (f.114, p. 1)

30 Po aty (f. 113, p. 4)

31 Hoti, Demë dhe Naser Zabeli. *Edukata Qytetare 9*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f. 11, p. 2)

ORIENTIMI SEKSUAL DHE IDENTITETI GJINOR SI DEVIJIME

Gjuha përjashtuese dhe stigmatizimi në tekstet shkollore i përcjell sidomos personat që nuk kanë orientim heteroseksual. Këto tekste nuk bëjnë dallimin e duhur mes seksit si kategori biologjike dhe gjinisë si kategori sociale, duke përjashtuar krejtësisht identitetin gjinor të atyre që nuk ndihen meshkuj e femra. Përshkrim të tillë hasim në tekstin *Psikologjia 11*, ku identiteti gjinor kufizohet në "...përvoja subjektive e të qenit mashkull ose femër"³². Formulimet në tekstet shkollore të marra si shembuj në seksionin më lart tregojnë qartë se personat me orientim joheteroseksual nuk konsiderohen pjesë e strukturës së quajtur familje. Për më tepër, në këto tekste homoseksualiteti barasvlerësohet me "Çrregullimet, sjelljen kriminale..."³³, apo edhe përshkruhet si sjellje që "...shmangen nga sjellja normale dhe shënohen si forma devijuese të sjelljes..."³⁴.

PORTRETIZIMI OFENDUES MBI BAZËN E AFTËSISË

Tekstet shkollore nuk janë të liruara as nga gjuha diskriminuese dhe denigruese mbi bazën e aftësisë. Ka formulime që përdorin gjuhë të pakujdesshme si «Zakonisht ne kemi parasysh një skizofreni, kur themi se dikush është i çmendur».³⁵ Por shqetësues është fakti që në kohën kur shoqëria jonë ka shtuar përpjekjet për përkrahjen e personave me Sindromin Doun që të jetojnë të integruar në shoqëri, në të njëjtën kohë në katër tekste të ndryshme të biologjisë për klasat 10 - 12 ky sindrom përkufizohet me "idiota mongoloid". Në këtë aspekt shkohet edhe më tutje duke shkruar se "...personat e tillë sipas pamjes së fytyrës dhe syve i përngjajnë racës mongole, ndërsa janë me ngecje të madhe mentale, me rritje të shkurtër, truri i zvogëluar, dermatoglifet karakteristike dhe jetojnë më së shumti 10-15 vjet.»³⁶ Termi ofendues "idiota mongoloide" është braktisur dekada më parë, ndërsa përdoret termi "Sindromi Doun".

32 Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 78, p. 3)

33 Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f. 102, p. 1)

34 Berisha, Ahmet, Ismet Bajraktari, Kasamedin Abdullahu dhe Agim Gashi. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 136, p. 3); dhe po ashtu: Bajraktari, Ismet D, Ahmet Berisha, Fetah Halili dhe Agim Gashi. *Biologjia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f. 27, p. 5)

35 Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 208, p. 3)

36 Bajraktari, Ismet, Ahmet Berisha, Fetah Halili dhe Haqif Qerimi. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012 (f. 180, p. 1)

NXITJA E DHUNËS DHE DEHUMANIZIMI

Gjuha e përdorur në tekstet shkollore shpesh është e pakontrolluar në përdorimin e terminologjisë, duke nxitur dhunë. Tashmë është përmendur një rast i përdorimit të kësaj gjuhe: «...skenat e llahtarshme të barbarisë së eskardroneve gjakatare...»³⁷. Kjo gjuhë shpesh çon në stigmatizimin e viktimave, si në këtë rast që po ashtu është përmendur më lart: «Ata në qershor e gusht të vitit 1944, torturuan, therën e vranë me mijëra burra, çnderuan me qindra gra dhe të reja.»³⁸ Në vend të termit përdhunim përdoret fjala çnderim, gjë që kontribuon tej mase në stigmatizimin e viktimave të dhunës seksuale. Një rast i ngjashëm haset edhe në tekstin Edukata Qytetare 10, ku thuhet: “Një tjetër tip i krimit të dhunshëm është përdhunimi me forcë”³⁹. Vetë fjala përdhunim nënkupton aktin seksual të kryer me forcë ose pa dëshirën e viktimës, prandaj formulimi që hasim është shumë i vrazhdë.

E patolerueshme është qasja e autorëve ndaj dhunës, sidomos kur flitet për dhunën në familje, ku ka tendenca të dehumanizimit të fëmijëve, legjitimitimit të formave të dhunës ndaj tyre dhe madje fajësimit të fëmijëve për problemet në familje. Më poshtë jepen disa raste të këtilla, të gjetura në tekstet shkollore të shqyrtuara. Në tekstin Edukata Qytetare 10, shkruhet: “Shumica e fëmijëve marrin nga një shuplakë herë pas here, gjë që natyrisht u sjellin vuajtje në disa plane”⁴⁰. Autorët mjaftohen me atë që këto shuplaka u sjellin vuajtje fëmijëve në disa plane, pa marrë mundin të shtjellojnë të gjitha pasojat e mundshme. Ndërkohë, sipas Asociacionit Psikologjik Amerikan “abuzimi fizik i referohet lëndimit të një fëmije me qëllim, p.sh. goditjet, rrahjet, kafshimet, ose çdo veprim që çon në lëndime fizike”⁴¹. Ndërsa më tutje tregohet se “Fëmijët që i nënshtrohen abuzimit dhe neglizhimit zakonisht e përceptojnë botën si një vend jostabil dhe të rrezikshëm, i cili mund të dëmtojë ndjenjën e vetëvlerësimit dhe aftësinë e tyre për t'u përballuar dhe për t'u përshtatur me mjediset e tyre ku rriten....”⁴²

Për të dëshmuar sa serioze është kjo çështje, të njëjtët autorë të tekstit të edukatës qytetare që iu referuam me formulimin paraparak, në një tekst tjetër shkruajnë «Duke u nisur nga fakti që teknikat dënuese janë e vetmja

37 Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 205, p. 4)

38 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 210, p. 5)

39 Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f. 77, p. 4)

40 Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 171, p. 2)

41 American Psychological Association <http://www.apa.org/pi/families/resources/understanding-child-abuse.aspx>

42 Po aty.

nga metodat efektive që e inkurajojnë fëmijën të sillët siç duhet, prindërit shpesh përdorin dënimet fizike të disiplinonjë fëmijët e tyre.»⁴³. Ky formulim është skandaloz, pasi autorët i legjitimojnë teknikat dënuese si të vetmet metoda efektive për t'i bërë fëmijët të sillen si duhet. Një rast tjetër ku fëmijët në vend që të shihen si viktime, shihen si pjesë e problemit është formulimi i cili merret me problemet e familjes bashkëkohore, ku si shkak i parë i këtyre problemeve identifikohet delikuenca e të miturve: «Problemet kryesore të familjes bashkëkohore janë: - Delikuenca e të miturve, - Përdorimi i mjeteve stimuluese të dëmshme si narkotikët, duhani etj, - Problemet me përdorimin dhe ushtrimin e dhunës në familje, - Divorci dhe problemet që e përcjellin këtë dukuri, - Abuzimi seksual.»⁴⁴ Fjalja është tendencioze dhe ka për qëllim fajësimin e fëmijëve. Në fakt delikuenca e të miturve është rezultat i neglizhimit dhe dhunës që i nënshtrohen fëmijët gjatë rritjes, dhe problemeve sociale dhe ekonomike me të cilat përballen shumë familje sot.

SHEMBUJT E PAPËRSHTATSHËM E LIDHJET JORELEVANTE

Në tekstet shkollore të shqyrtuara janë gjetur formulime ku autorët japin shembuj të papërshtatshëm apo krijojnë lidhje jo të duhura me çështjen që shtjellohet në ato tekste. Në rastin më të mirë këta shembuj e këto lidhje shkaktojnë paqartësi te nxënësit, e në rastin më të keq përforcojnë stereotipet dhe janë përjashtuese ndaj grupeve të ndryshme. Kështu, është vështirë të krijohet lidhja e duhur nga ana e lexuesit për formulimin në vijim: «Në vitet e fundit janë rritur mjaft në numër familjet ku punojnë të dy. Një gjë e tillë është rrjedhojë e faktit që gratë e martuara tashmë punojnë jashtë shtëpisë»⁴⁵, që lidhet me "familjet ku punojnë të dy bashkë". Paramendojmë se sa pyetje mund të lindin në mendjet e nxënësve, të cilat nëse nuk adresohen e diskutohen, mbeten pëgjithmonë të paqarta.

Sqarimi i refleksit të kushtëzuar përmes "Bukuroshja (stimuli i kushtëzuar) shkakton emocione pozitive (reagimi i kushtëzuar)"⁴⁶ i kufizon cilësitë e gruas në tiparet fizike të saj dhe si i tillë është shembull i papërshtatshëm dhe irritues i objektivizimit të gruas. Ka edhe raste të tjera të tilla, si «... dallohet fytyra e një plake dhe fytyra e një bukuroshe të re»⁴⁷. Në këtë rast diskriminimi është i dyfishtë. Etiketimi "bukuroshe" është i ngjashëm si tek

43 Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f. 87, p. 2)

44 Berishaj, Anton, Ibrahim Berisha dhe Ismajl Hasani. *Sociologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011 (f. 33, p. 2)

45 Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 148, p. 2)

46 Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012 (f. 85, p. 4)

47 Po aty, (f. 74, p. 2)

rasti me formulimin më sipër, ndërsa krahasimi i fytyrës së një plake dhe fytyrës së një bukurosheje, ka edhe premisa të diskriminimit mbi bazë moshe.

Shembujt që merren për të shtjelluar temën, i paraqesin gratë negativisht edhe në aspekt të aftësive. "Të këtilla janë shprehjet: "Mirë se shkoni"- zonja e shtëpisë u uron mirëseardhjen miqve të ftuar për darkë nga bashkëshorti i saj!"⁴⁸ paraqet një familje ku burri i fton miqt e tij për darkë, ndërsa gruaja i mirëpret dhe u shërben, por edhe këtë gjë nuk e bën si duhet. Në anën tjetër, në pjesën dërmuese të shembujve që lidhen me personalitetet historike paraqiten burrat. Ja një shembull i këtillë: "Njeriu thotë se po mendoj për rolin e Abdyl Frashërit në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për skulpturën e Skënderbeut, për pasojat e luftës, për teorinë e Çarls Darvinit..."⁴⁹

NXËNËSIT PARA PYETJEVE E DETYRAVE SUGJESTIVE E TENDENCIOZE

Ka raste kur nxënësit që përdorin tekstet shkollore vihen para situatave të palakmueshme kur duhet t'u përgjigjen pyetjeve, ose të kryejnë detyrat që jepen në fund të njësisë mësimore, e të cilat janë të dhëna në gjuhë diskriminuese. Për shembull, nxënësve u kërkohet që të përshkruajnë "... një ndodhi që hyn në kujtesën tuaj si e pakëndshme e që është e lidhur me marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë..."⁵⁰ Një detyrë e tillë stimulon ndjenjen e urrejtjes etnike, në vend se të bëjë të kundërtën.

Në një rast tjetër një nga pyetjet në fund të njësisë mësimore është kjo: «5. Çfarë pasojash ka për shoqërinë përkushtimi i femrave ndaj karrierës?»⁵¹ Ky formulim është përmendur edhe më lartë, në kontekst të pabarazisë ekonomike-sociale midis burrit e gruas. Këtu, theksi vihet mbi pozitën në të cilën bien nxënësit kur duan të përgjigjen. Pyetja është tejet sugjestive dhe i orienton nxënësit të mendojnë për "pasojat". Një nxënës duhet të jetë shumë i guximshëm dhe të refuzojë të përgjigjet në këtë pyetje, ose të japë këndvështrimin se nuk bëhet fjalë për ndonjë pasojë, po përkundrazi për përfitime shoqërore nga ky fakt.

48 Po aty, (f.123, p. 1)

49 Po aty, (f.110, p. 1)

50 Berishaj, Anton, Ibrahim Berisha dhe Ismajl Hasani. *Sociologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011 (f. 57, p. 6)

51 Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014 (f. 85, p. 4)



PASAKTËSITË DHE MUNGESA E REFERENCAVE PËR INFORMATAT

Shumica e teksteve shkollore të shqyrtuara përmbajnë informata të pasakta. Pasaktësitë nuk janë pjesë e kësaj analize, por ndikimi i tyre në gjuhën diskriminuese në disa raste bën që t'i shtjellojmë në këtë seksion. Për subjektin e kësaj analize, është pak me rëndësi që në një tekst shkollor të botuar në vitin 2016 thuhet se «Në planetin Tokë sot jetojnë rreth 6 miliardë njerëz.»⁵², kur dihet se që në vitin 2011, popullata i kaloi 7 miliardë⁵³. Nuk është i lidhur me analizën as fakti që në një tekst shkollor të shkruar në vitin 2016 shkruan se «Kosova synon të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, i cili përfshin 25 vende...»⁵⁴, kur Kroacia që në vitin 2013 është vendi i 28-të i BE-së.⁵⁵ Mirëpo, informatat e pasakta lidhur me numrin e të vvarëve në luftën e fundit në Kosovë, të tipit "...gjatë muajve të bombardimit të forcave ajrore të NATO-s ushtria serbe vrau rreth 15.000 shqiptarë..." nxisin urrejtje dhe nuk i shërbejnë as mësimit të historisë, e as mësimëve jetësore mbi bazën e fakteve historike.

Në tekstet shkollore, në shumicën e rasteve, autorët nuk ofrojnë referenca për burimet e informatave, që do të lejonin verifikimin e informatave, por edhe mundësinë për studimin më të thellë të çështjes së studimit. Edhe atëherë kur u referohen teorive apo studimeve, nuk e japin qartë burimin. Po ashtu, nuk ofrojnë listë të literaturës shtesë për temat që trajton lënda.

52 Berisha, Ahmet, Ismet Bajraktari, Kasamedin Abdullahu dhe Agim Gashi. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 161, p. 1)

53 Population Reference Bureau: <http://www.prb.org/Publications/Datasheets/2011/world-population-data-sheet.aspx>

54 Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 72, p. 3)

55 European Union: https://europa.eu/european-union/about-eu_en

3.2 NJOHURITË E NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA MBI ASPEKTE TË PËRGJITHSHME E TË VEÇANTA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT


Nxënësit që kanë aplikuar për të marrë pjesë në punëtori e kanë plotësuar paraprakisht një pyetësor me pyetje rreth të drejtave të njeriut. Pyetëtori është i dhënë në shtojcën 3. Pas përfundimit të punëtorisë, të rinjtë e kanë plotësuar sërish pyetësin e njëjtë.

Shumica dërmuese e respondentëve kanë deklaruar se kanë mësuar ndonjëherë për konceptin e të drejtave të njeriut në shkollën e tyre. Kur u është kërkuar të japin detaje rreth përmbajtjes, shumica dërmuese kanë përmendur se kanë mësuar për ligjet dhe instrumentet ndërkombëtare, por fare pak kanë përmendur ndonjë aspekt të veçantë. Kryesisht këto mësimë i kanë marrë përmes lëndës së edukatës qytetare.

Nxënësve u është kërkuar të tregojnë se cilat janë të drejtat e tyre themelore. Për të administruar në mënyrë më të strukturuar përgjigjet është bërë një kodim mbi bazën e të drejtave të proklamuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Përgjigjet e shkruara janë deshifruar dhe janë kategorizuar sipas kodimit të bërë. Vetëm tre respondentë i kanë shkruar 5 të drejta dhe shtatë respondentë të tjerë 4 të drejta. Pjesa tjetër ka arritur të identifikojë 2-3 të drejta. Të drejtat e identifikuara më së shumti janë: Liria e shprehjes së mendimit dhe pikëpamjeve (neni 12); E drejta në jetë, mbijetesë dhe zhvillim (neni 6); E drejta në arsimim (neni 28); Mbrojtja nga diskriminimi (neni 2); dhe E drejta në emër, shtetësi dhe kombësi (neni 7).


Nxënësit janë pyetur cilës përkatësi etnike u përkasin njerëzit që kanë humbur jetën në luftën e fundit. Ka një dallim domethënës në përgjigjet e dhëna në pyetësorë para dhe pas punëtorisë. Kështu, para punëtorisë, 37.3% të respondentëve janë përgjigjur se në luftën e fundit jetën e kanë humbur vetëm shqiptarët, ndërsa vetëm më pak se 8.9% prej tyre e kanë mbajtur këtë mendim edhe pas punëtorisë. Më së shumti, sidoqoftë janë përgjigjur se ata që kanë humbur jetën janë nga të gjitha grupet etnike, me ndryshimin që numri i respondentëve që kanë zgjedhur këtë opsion është rritur nga 49.2% para punëtorisë, në 75.6% pas punëtorisë.

Grafiku nr. 1. Cilës etni i përkasin njerëzit që humbën jetën në luftën e fundit



Disa pyetje specifike kanë qenë të lidhura me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si dhe me fenomenet shoqërore që lidhen me to. Në pyetjen rreth nocioneve seks dhe gjini, para punëtorisë 32.2% të respondentëve janë përgjigjur saktë, derisa pas punëtorisë kjo përqindje është rritur në 57.8% të respondentëve. Lidhur me këtë janë 27.1% të respondentëve që para punëtorisë nuk e kanë ditur, ndërsa të tillë pas punëtorisë kanë ngelur vetëm 2.2%. Kjo do të thotë se pas punëtorisë shumica e tyre e kanë krijuar idenë rreth nocioneve të seksit dhe gjinisë.


Grafiku nr. 2. Saktësia e përkufizimit të seksit e gjinisë



Në anën tjetër, ata që janë përgjigjur gabimisht, në shumicën e rasteve kanë deklaruar se seksi është marrëdhënie intime ose marrëdhënie seksuale midis çiftit.


Të pyetur se për çfarë qëndron akronimi LGBT, para punëtorisë 54.2% e tyre nuk e kanë ditur, ndërsa 44.1% po. Ndërsa pas punëtorisë 91.1 e kanë ditur, karshi vetëm 8.9% të respondentëve që nuk e kanë ditur.

Grafiku 3: Njohuritë për akronimin LGBT




Të pyetur për nocionin e homofobisë, para punëtorisë 30.5% e respondentëve kanë dhënë një përkufizim të saktë, ndërsa 13.6% të gabueshëm. Më shumë se gjysma e tyre, apo 50.8% janë deklaruar se nuk e dinë. Pas punëtorisë, përqindja e atyre që kanë dhënë përkufizim të gabuar ka rënë në 4.4%, ashtu sikur se ka rënë në 17.8% përqindja e atyre që nuk e kanë ditur. Ndërkaq përkufizim të saktë kanë dhënë 73.3% e respondentëve karshi përqindjes dukshëm më të vogël para punëtorisë (30.5%). Përafërsisht i njëjtë është dallimi para dhe pas punëtorisë edhe kur bëhet fjalë për nocionin "seksizëm".

Grafiku 4: Saktësia e përkufizimit të homofobisë




Grafiku 5: Saktësia e përkufizimit të seksizmit



Dukshëm më i madh është dallimi lidhur me nocionin "mizogjini". Te mizogjinia, para punëtorisë vetëm 1.7% të repondentëve kanë qenë të saktë, ndërsa pas punëtorisë 62.2% janë përgjigjur saktë. Pjesa dërmuese prej 94.9 % nuk e kanë ditur nocionin e mizogjinisë para punëtorisë, ndërsa pas punëtorisë, vetëm 31.1 % nuk kanë ditur të përgjigjen në të njëjtën pyetje.

Këto rezultate tregojnë se përmes punëtorisë nxënësit kanë mësuar për aspektet që lidhen me orientimin seksual e identitetin gjinor, si dhe fenomenet e lidhura me to. Kjo po ashtu tregon mungesën e trajtimit të këtyre aspekteve të të drejtave të njeriut në shkolla.

Grafiku 6: Saktësia e përkufizimit të mizogjinisë




Të shtyer nga përkufizimi që i bëhet familjes në tekstin shkollor të edukatës qytetare të klasës së 9-të⁵⁶, është përpiluar një pyetje për të parë opinionet e nxënësve për llojet e ndryshme të familjes sipas përbërjes. Derisa pothuajse të gjithë nxënësit mendojnë se familja me nënë e baba dhe fëmijët e tyre janë familje e plotë dhe në harmoni, kështu nuk mendojnë edhe për disa lloje të ndryshme të familjes. Kështu para punëtorisë 35.6% e nxënësve respondentë kanë menduar se familja me dy nëna është familje e plotë dhe në harmoni, derisa 64.45 kanë menduar se kjo është familje jo e plotë dhe e çrregullt.


Pas punëtorisë, ky raport ka ndryshuar pasi prej atyre që janë përgjigjur, 77.8% kanë menduar se kjo është familje e plotë dhe në harmoni, ndërsa 17.8% prej tyre kanë mbetur në mendimin se kjo është familje jo e plotë dhe e çrregullt. Pak a shumë tendencë të njëjtë tregojnë rezultatet që kanë dalë edhe për familjen me një prind dhe fëmijën/t e tij/saj, familjen me dy etër dhe fëmijën/t e tyre, familjen pa prindër dhe familjen me dy prindër dhe fëmijën/t e tyre të lindur jashtë martesës.

⁵⁶ Hoti, Demë dhe Naser Zabeli. *Edukata Qytetare 9*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015 (f. 11, p. 2)


Grafiku 7: Familje me nënë dhe baba të martuar dhe fëmijën/t e tyre




Grafiku 8: Familje me dy nëna dhe fëmijën/t e tyre




Grafiku 9: Familje me një prind dhe fëmijën/t e tij/saj




Grafiku 10: Familje me dy etër dhe fëmijën/t e tyre



Grafiku 11: Familje pa prindër




Grafiku 12: Familje me dy prindër dhe fëmijën/t e tyre të lindur jashtë martesës




Të pyetur se a ka nevojë për një lëndë të edukimit seksual në shkollën e tyre, pothuajse të gjithë nxënësit janë përgjigjur me "po". Ky rezultat është edhe para edhe pas punëtorisë.

Janë interesante rezultatet lidhur me dy pyetjet e fundit në pyetësor, njëra që lidhet me sa janë të kënaqur nxënësit me njohuritë që i marrin në sistemin arsimor në Kosovë, dhe tjetra nëse ata besojnë se shoqëria kosovare është shoqëri gjithëpërfshirëse, ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta. Lidhur me sistemin e arsimit para punëtorisë nxënësit kanë qenë të ndarë në mënyrë përafërsisht të barabartë, pra 47.5% janë deklaruar të kënaqur dhe 47.5% të pakënaqur, ndërsa pas punëtorisë shumë më tepër nxënës janë treguar të pakënaqur me njohuritë që i marrin në sistemin arsimor, më konkretisht 60% e tyre, ndërsa mbi 35.6% kanë ngelur të kënaqur. Ndërsa lidhur me shoqërinë kosovare, si para ashtu edhe pas punëtorisë nxënësit kanë qenë shumë kritikë në vështrim të gjithëpërfshirjes dhe mundësive që i'u ofron shoqëria. Vetëm rreth 10% e tyre janë të kënaqur.

Grafiku 13: Sa jeni të kënaqur me njohuritë që i merrni në sistemin arsimor në Kosovë?



Grafiku 14: A besoni se shoqëria kosovare është shoqëri gjithëpërfshirëse, ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta?



Lidhur me këto opinione të nxënësve, shihet se kanë qenë shumë më kritikë për mundësitë që u ofrohen nga shoqëria kosovare, ndërsa më pak kritikë ndaj njohurive që u ofron sistemi i arsimit. Megjithatë, pas punëtorisë nxënësit kanë menduar në mënyrë më kritike rreth arsimit të tyre, duke shtuar dozën e pakënaqësisë mbi arsimimin që marrin brenda sistemit arsimor, me gjasë, të ndikuar nga mësimet që i morën në një mjedis joformal të të nxënësve dhe reflektimit mbi mostrajtimin e këtyre mësimëve në sistemin formal të arsimit.

4. PËRFUNDIMI

Nxënësit në Kosovë, edhe në shkollat e mesme të larta vazhdojnë të përballen me tekste shkollore ku ka gjuhë diskriminuese e përjashtuese. Themi “edhe në shkollat e mesme”, sepse analizat e bëra më herët kanë dokumentuar që edhe në nivelin e shkollës fillore dhe të mesme të ulët, tekstet shkollore përdorin gjuhë të tillë. Themi “vazhdojnë”, pasi është një gjendje e identifikuar që shumë vjet dhe që mbetet e tillë, mbase me përmirësime kozmetike. Në analizën e publikuar në vitin 2013, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN⁵⁷ ka ardhur në përfundim se tekset shkollore të ciklit të shkollës së mesme të ulët krahas të metave të tjera, vuajnë edhe nga prania e diskriminimit, paragjyqimeve dhe stereotipeve gjinore. Analiza ishte bërë për të parë nëse ishin përmirësuar një varg problemesh, defektesh dhe mangësish, të cilat ishin identifikuar në një studim të mëhershëm të vitit 2010, po nga e njëjta organizatë. Një analizë tjetër e publikuar në vitin 2007 nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, me titull “Auditimi i çështjeve gjinore në sistemin arsimor”⁵⁸ ka përfshirë edhe një analizë të çështjeve gjinore në tekstet shkollore. Analiza ka treguar se janë shumë të theksuara stereotipet gjinore në tekstet shkollore jo vetëm në përmbajtje të shkruar, por edhe në ilustrime dhe reprezentime.

Janë nga më të ndryshmet llojet e diskriminimit që identifikohen në gjuhën e përdorur në tekstet shkollore. Dominojnë rastet e gjuhës diskriminuese mbi bazën e etnisë, gjinisë e marrëdhënieve në familje, orientimit seksual dhe aftësisë, por nuk mungojnë raste të diskriminimit mbi bazën e statusit ekonomik-shoqëror, moshës, religjionit, etj. Mënyrat se si shfaqet kjo gjuhë diskriminuese janë: përjashtimi i grupeve të caktuara, përshkrimet e karakterizuara nga konstruktet e vjetra sociale, ofendimet ndaj pjesëtarëve të këtyre grupeve, madje edhe etiketimi i tyre. Në anën tjetër, ka lartësim të pjesëtarëve të grupeve tjera që shkojnë deri në romantizëm, përfaqësim mbizotërues të pjesëtarëve të këtyre grupeve dhe ekzagjerim të fakteve të shoqëruara me pasaktësi.

57 BIRN: http://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/05/Textbooks-Analyze_Albanian.pdf

58 Qendra Kosovare për Studime Gjinore: <http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/05/AUDITIMI%20I%20CE%20SHTJEVE%20GJINORE%20NE%20SISTEMINARSIMOR%20%80%9D.pdf>

Të metat më të mëdha të teksteve shkollore që ka nxjerrë në pah analiza janë këto:

- Në tekstet e historisë ka njëanshmëri të theksuar kur shtjellohen faktet historike, duke i paraqitur shqiptarët si të vetmin popull autokton në Gadishullin Ballkanik, duke i portretizuar shqiptarët si të vetmin popull viktimë në luftën e fundit përmes numrit të fryrë të të vrarëve të përkatësisë etnike shqiptare dhe neglizhimit të plotë të të vrarëve të etnive të tjera, etj.;
- Diskriminimi gjinor është i theksuar, duke filluar me paragjykimet e stereotipet gjinore që i mbërthejnë gratë brenda "rolit të tyre" tradicional, duke vazhduar me përshkrimet seksiste madje edhe kur shtjellohen çështje shkencore, e duke përfunduar me etiketimin e grave mbi bazën e karakteristikave të tyre fizike e psikike;
- Orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk trajtohet në përputhje me zhvillimet bashkëkohore, por përkundrazi me tendencën që gjithçka që nuk përkon me heteroseksualitetin të paraqitet si devijim;
- Aspektet e aftësisë trajtohen pa kurrfarë ndjeshmërie. Sindromi Doun përshkruhet me termin ofendues "Idioti mongoloid" dhe për personat me këtë sindrom jepen informata krejtësisht të pasakta, madje edhe për jetëgjatësinë e tyre;
- Përdoret gjuhë e ashpër në përshkrimin e fakteve, duke nxitur urrejtje;
- Nxënësit ballafaqohen me detyra e pyetje sugjестive dhe tendencioze. Përmes tyre nxiten paragjykimet e stereotipet, në vend që të inkurajohet mendimi kritik dhe ndjenja e harmonisë shoqërore.

Analiza ka gjetur edhe probleme sistemore në lidhje me tekstet shkollore. Pavarësisht se politikat arsimore dhe rregullativa në këtë fushë nuk kanë qenë pjesë e analizës, ka qenë e pamundur të dizenjohet dhe të zbatohet kjo analizë pa një hulumtim të shpejtë të tyre. Kështu, standardet për tekstet shkollore janë miratuar në vitin 2011 përmes udhëzimit administrativ 5/2011.⁵⁹ Në tekstet shkollore të shqyrtuara gjejmë pak nga përmbajtja e dokumentit. Kështu, gjetjet nga analiza tregojnë për shembull se standardet e përcaktuara për tekstet shkollore nuk përfillen fare. Po i numërojmë këtu vetëm disa standarde që drejtpërdrejt lidhen me fushën e kësaj analize: Standardi 10 - Lidhjet me aspektet edukim për pjekuri/pavarësi, edukim për demokraci, edukim paqësor; Standardi 11 – Reflektimi i barazisë gjinore; Standari 7 – Pyetjet dhe detyrat; etj.

59 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:
<http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-e-teksteve.pdf>

Ligji 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrave shkollore dhe i dokumentacionit pedagogjik është miratuar në vitin 2006. Neni 3.2 i këtij ligji thotë: “Nuk lejohen tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyrat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik që bëjnë propagandë kundër Kosovës, që cenojnë të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore dhe që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare”.⁶⁰ Analiza zbulon se në praktikën e teksteve shkollore ndodh pikërisht e kundërta. Më tutje në nenin 4.3 thuhet: “Recensentët bëjnë vlerësimin kritik me shkrim për një tekst shkollor, një vepër artistike, një punim shkencor para botimit të tyre”. Nuk kemi gjetur emrin e ndonjë recensenti/je në ndonjërin nga tekstet e shqyrtuara.

Një komision për rishikimin e teksteve shkollore është formuar në vitin 2015 në nivel të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por nuk kemi rezultate nga puna e këtij komisioni.

Pra, ndonëse ekziston një kornizë ligjore për tekstet shkollore, mungon sistemi për sigurimin e cilësisë së teksteve shkollore. Kështu:

- Tekstet shkollore përmbajnë gjuhë diskriminuese e përjashtuese, si dhe informata që nuk përmbajnë referenca të burimeve.
- Mungesa e recensentëve, dëshmon mungesën e filtrit të parë.
- Nuk ka diversitet të autorëve dhe shtëpive botuese. Të njëjtit autorë i kanë shkruar shumicën e teksteve shkollore të një lënde dhe gabimet e njëjta reflektohen në të gjitha tekstet. Madje të gjitha tekstet e shqyrtuara janë të botuara nga e njëjta shtëpi botuese.
- Ka raste kur i njëjti formulim diskriminues paraqitet në tekste shkollore me autorë të ndryshëm.
- Çuditërisht, vendimet për lejimin e teksteve janë marrë shumë vjet para se të botohen tekstet. Një shembull: “Tekstin e lejoi Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë me Vendimin nr. 491/02-1, më 04.07.2005”.⁶¹

⁶⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2437>

⁶¹ Bicaj, Isa, dhe Isuf Ahmeti. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016 (f. 2)

Tekstet e këtilla shkollore janë larg të qenit burime që i kontribuojnë arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar siç i përcakton korniza e kurrikulës: "...nëpërmjet zhvillimit të dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinjve të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, të përballen në mënyrë konstruktive me dallimet dhe sfidat, si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve".⁶² Përmbajtja e këtyre teksteve, por edhe mungesa e metodova bashkëkohore për trajtimin e kësaj përmbajtjeje nëpër klasa, i vë mësimdhënësit e nxënësit në vështirësi, duke bërë që të kërkojnë burime tjera të informacionit dhe mënyra më efektive për të trajtuar përmbajtjen mësimore.

Të rinjtë e shkollave të mesme të larta kanë ndjekur punëtoritë e organizuara nga projekti. Punëtoritë lidheshin me koncepte të përgjithshme të të drejtave të njeriut, si dhe me aspekte të veçanta siç janë: orientimi seksual dhe identiteti gjinor, drejtësia tranzicionale, barazia gjinore, etj. Metodologjia e përdorur në këto punëtori ishte përmes të mësuarit aktiv dhe në bashkëpunim, metodologji që tekstet shkollore të shqyrtuara nuk e nxisin fare. Pjesëmarrësit i kanë plotësuar pyetësorët që lidheshin me përmbajtjen e punëtorisë, fillimisht para punëtorisë dhe pastaj sërish pas përfundimit të punëtorisë. Analiza e rezultateve të pyetësorëve tregon se ka një dallim të madh në mes të përgjigjeve të dhëna para dhe pas punëtorisë. Pas punëtorisë nxënësit kanë treguar njohuri të shtuara për aspektet e të drejtave të njeriut. Nga kjo përfundohet se shtjellimi në mënyrë të duhur i aspekteve të veçanta të të drejtave të njeriut, ka ndikim në krijimin e njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve demokratike dhe qytetare te nxënësit.

62 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:
<http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

5. REKOMANDIMET

Duke u bazuar në rezultatet e analizës dhe në përfundimet e nxjerra, ofrojmë rekomandime për palët e përfshira në arsim.



PËR MINISTRINË E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË:

- Të rishikohet ligji 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, veçanërisht i seksionit II, vlerësimi dhe lejimi i teksteve shkollore, mjeteve mësimore dhe dokumentacionit pedagogjik. Në varësi të procesit të rishikimit, duhet të iniciohet ndryshimi i ligjit, ose nxjerrja e një ligji të ri.
- Të hartohet një udhëzues praktik për shtëpitë botuese dhe autorët e teksteve shkollore, për zbatimin e standardeve të teksteve shkollore. Promovimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut duhet të jetë në themel të këtij udhëzuesi.
- Të dizajnohet një program trajnimi për autorët e teksteve shkollore dhe të ofrohet çdo vit për shtëpitë botuese dhe për autorët e interesuar. Trajnimi duhet t'u ofrohet edhe zyrtarëve të arsimit.
- Të hapet procesi i botimit të teksteve shkollore, duke siguruar një diversitet të autorëve e shtëpive botuese. Duhet mundësuar që edhe autorët e pavarur të ofrojnë propozimet e tyre.
- Të funksionalizohet komisioni për rishikimin e teksteve shkollore, apo ndonjë trup tjetër në nivel të Ministrisë që në mënyrë të vazhdueshme do të mbikëqyrë tekstet shkollore, si dhe do të marrë pjesë aktive në procesin e botimit të teksteve shkollore. Vetë komisioni duhet të jetë me përbërje të gjerë dhe të ftojë ekspertë të pavarur, përfaqësues të shoqërisë civile, dhe prindërve. Përcaktimi i kriterëve për përzgjedhjen e autorëve të teksteve shkollore. Duhet krijuar një kanal transparent komunikimi mes këtij komisioni apo trupi dhe mësimitdhënësve, prindërve, ekspertëve të arsimit e qytetarëve tjerë, për çdo çështje që lidhet me tekstet shkollore.
- Të sigurohet që tekstet shkollore të kalojnë nëpër procesin e recensionit të dyfishtë që mundëson vlerësim kritik të teksteve.
- Të bëhet pilotimi i teksteve shkollore nga mësimitdhënësit dhe nxënësit.
- Të gjitha tekstet shkollore duhet të iu nënshtrohen shikimit të përmbajtjes nga perspektiva gjinore.
- MASHT-i të raportojë në baza vjetore në Parlamentin e Kosovës për përdorimin e teksteve shkollore dhe ndikimin në nxënie dhe mësim.

6. BIBLIOGRAFIA

American Psychological Association, <http://www.apa.org> qasur së fundi më 19.11.2017

Population Reference Bureau <http://www.prb.org/Publications/Datasheets/2011/world-population-data-sheet.aspx> qasur së fundi më 19.11.2017

Auditimi i çështjeve gjinore në sistemin arsimor. Prishtinë: QKSGj, 2007: <http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/05/AUDITIMI%20I%20CE%20SHTJ%20E%20GJINORE%20NE%20SISTEMIN%20ARSIMOR%20E%20PRISHTINE.pdf>

European Union https://europa.eu/european-union/about-eu_en qasur së fundi më 19.11.2017

Fondi për të Drejtën Humanitare – “Libri Kujtimi i Kosovës 1988 – 2000” http://www.kosovskaknjigapamcjenja.org/?page_id=48&lang=zh qasur së fundi më 19.11.2017

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> qasur së fundi më 19.11.2017

Plaid Zebra: <http://www.theplaidzebra.com/science-finally-supports-that-we-are-all-born-as-blank-slates-and-gender-is-merely-a-construct/>

Raporti vjetor i UNHCR 1999, kapitulli 12: refugjatët dhe personat e zhvendosur <http://www.unhcr.org/4e1ee787a.pdf> qasur së fundi më 19.11.2017

Thaçi, Jusuf. Problemet dhe te metat e teksteve shkollore. Prishtinë: BIRN, 2013 http://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/05/Textbooks-Analyze_Albanian.pdf qasur së fundi më 19.11.2017

UN Human Rights Office of the High Commissioner <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx> qasur së fundi më 19.11.2017

7. SHTOJCAT

7.1 TEKSTET SHKOLLORE TË SHQYRTUARA

- Abdyli, Ramiz dhe Emine Bakalli. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015
- Bajraktari, Ismet, Ahmet Berisha, Fetah Halili dhe Haqif Qerimi. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012
- Bajraktari, Ismet, Haqif Qerimi, Fetah Halili dhe Agim Gashi. *Biologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Bajraktari, Ismet, Gecaj Abdulla, Qazim Pajazitaj, Daut Rexhepaj, Esmë Rugova dhe Ferdie Zhushi Etemi. *Biologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014
- Bajraktari, Jusuf dhe Isa Bicaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2006
- Bajraktari, Jusuf dhe Arbër Salihu. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013
- Berishaj, Anton, Ibrahim Berisha dhe Ismajl Hasani. *Sociologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011
- Berishaj, Anton dhe Ibrahim Berisha. *Sociologjia 12 e 13*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012
- Berisha, Ahmet, Abdulla Gecaj, Mujë Plakolli, Qazim Pajazitaj, Esmë Rugova dhe Ferdije Zhushi – Etemi. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Berisha, Ahmet, Haqif Qerimi, Ismet Bajraktari dhe Fetah Halili. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012
- Berisha, Ahmet, Ismet Bajraktari, Kasamedin Abdullahu dhe Agim Gashi. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Berisha, Ahmet, Ismet Bajraktari, Kasamedin Abdullahu dhe Agim Gashi. *Biologjia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Bicaj, Isa, dhe Arbër Salihu. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Bicaj, Isa dhe Isuf Ahmeti. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Hoti, Demë dhe Naser Zabeli. *Edukata Qytetare 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015
- Hoti, Demë dhe Naser Zabeli. *Edukata Qytetare 9*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015
- Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016
- Mato, Erlehta dhe Bajram Shatri. *Edukata Qytetare 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015
- Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2014
- Nushi, Pajazit, Neki Juniku dhe Dashamir Bërxulli. *Psikologjia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012
- Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2015
- Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2016

7.2 LISTA E FORMULIMEVE ME GJUHË DISKRIMINUESE

Libri	Klasa	Drejtimi	Faqe	Paragrafi	Citati
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	10	3	"Qeveria mbron popullin nga armiqtë e kombit"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	14	2	"...dhe partitë e minoriteteve tjera që jetojnë në Kosovë"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	17	1	*Foto e logove të partive shqiptare*
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	40	4	"...Kosovë (komuniteti kombëtar)"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	41	6	"Ky mund të jetë një familje e ngushtë (prindërit dhe fëmijët) ose një familje e zgjeruar (gjyshërit, xhaxhallarët, tezet, kushërinjtë)"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	42	6	"Komuniteti kombëtar përfshin të gjitha komunitetet që përmenden më lart. Njerëzit identifikohen fuqishëm me kombin e tyre."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	42	9	"Kultura shqiptare shtrihet te vlerat, kuptimet dhe identiteti që njerëzit e vendit tonë ndajnë. Kultura shqiptare është e dallueshme dhe e ndryshme."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	43	1	"Ne mund ta përshkruajmë kulturën shqiptare në termat e muzikës së saj, gjuhës sonë, krijimtarisë shekullore, sporteve të preferuara dashurisë për natyrën"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	45	7	"Të ndihmojnë njerëzit pa shtëpi dhe lypësat"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	45	9	"Informacioni lokal dhe këshillimi me njerëzit e nivelit lokal përmirëson hartimin e politikave kombëtare"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	50	3	"Shiu i acidit është një problem ndërkombëtar, sepse ai i kalon kufinj të kombëtar"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	59	4	"Kështu, secili qytetar ka të drejtë të marrë pjesë plotësisht në jetën kombëtare, pavarësisht nga raca, feja dhe gjinia"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	61	2	"Diskriminimi mbështetet mbi racën, kombësinë, origjinën etnike, gjininë, orientimin gjinor, statusin bashkëshortor, opinionin personal politik, fetar, mbi moshën, shëndetin ose kritere të tjera."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	61	3	"Diskriminimi mund të shihet si i preferueshëm ose jo në vartësi mbi atë që një person pranon mundësitë që i jepen ose i janë mohuar ato."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	63	1	"Diskriminimi i drejtëpërdrejtë ndodh kur një person keqtrajtohet nga një person tjetër (i një gjinie tjetër) ose një person i të njëjtës gjinie por me status bashkëshortor të ndryshëm"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	63	2	"Diskriminimi jo i drejtëpërdrejtë ndodh kur një person është i detyruar të plotësojë kërkesat e punës që nuk është baza e tij, e cila kërkon më shumë sasi dhe forcë fizike, duke e krahasuar me persona të gjinisë tjetër."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	66	4	"P.Sh., ekspertët ligjorë argumentojnë se shprehja e ideve të caktuara është e dëmshme për publikun, ajo mund të sjellë rrezikim të interesave kombëtare"
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	77	4	"Një tjetër tip i kimit të dhunshëm është përdhunimi me forcë."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	81	7	"Viktimat e trafikimit nuk janë dhe nuk duhet të paragjykojnë si prostituta me vullnetin e tyre."

Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	86	4	"Kur përmendim rastin e shuplakës që një shumicë e madhe prindërisht nuk kanë mund ta shmangin nga teknikat e tyre dënuese, shtrojmë edhe pyetjen cilën gjë do ta konsiderojmë si abuzim të fëmijët."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	87	2	"Duke u nisur nga fakti që teknikat dënuese janë e vetmja nga metodat efektive që e inkurajojnë fëmijën të silltet siç duhet, prindërit shpesh përdorin dënimet fizike të disiplinohen fëmijët e tyre."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	91	7	"Në një pjesë të madhe familjesh me origjinë fshatare ndëshkimi fizik shihet si pjesë e zakonshme e edukimit të fëmijës."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	102	1	"Çrregullimet, sjellja kriminale dhe homoseksualiteti i atribuohen filmave dhe librave erotike."
Edukata Qytetare	10	Shkolla e mesme profesionale	103	3	"Motivet romantike në film kanë më tepër ndikim të vëzhgueset femra, ndërsa meshkujt preferojnë më shumë "format fizike".
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	66	1	"Megalopolise (qytetet me disa milionë banorë) janë qendra të ndotjes psikosociale, siç është narkomania, kriminaliteti, neuroza."
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	67	1	"Në rënin e natalitetit në Evropë kanë ndikuar, përpos tjerash, edhe niveli i arsimimit të prindërve, planifikimi i familjes, pozita më e mirë ekonomike e gruas, migracionet, martesat e vonuara etj."
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	69	2	"Shkaqet e shfaqjes së sëmundjeve psikosomatike mund të jenë të ndryshme: mjedisi shoqëror patogjen, papjekuria e individës..."
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	68	1	"Në shëndetin mental të njeriut ndikojnë shumë faktorë, si: urbanizimi dhe hiperpopullimi, transformimi i rolit të familjes në mjedisin e ri urban, ritmi i shpejtuar i migrimit të popullatës, problemet e komunikacionit, dukuritë social-patologjike, në mjedisin urban, depresioni psikologjik, alkoolizmi, droga, vandalizmi, ndotja e mjedisit etj."
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	70	1	"Steriliteti gjithnjë e më i shprehur, abortimet spontane, lindja e foshnjëve të vdekura, anomalitë, çrregullime në sjellje, tumorët të fëmijët etj."
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	77	1	"Për ruajtjen e biodiversitetit, siç duket më shumë sens kanë pasur indianët amerikanë, sesa ardhacakët evropianë"
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	78	5	"Ekocid jo i qëllimshëm nënkupton zhdukjen graduale të ndonjë lloji shtazor (psh me gjueti) për shkak të lakmisë (interetit) të njeriut për mishin, lëkuren apo eshtrat e tij."
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	160	3	"Tash është e qartë se zhvillimi progresiv i jetës në tokë u kurorëzua me shfaqjen e njeriut, krijesë kjo e vetme me vetëdije në planetin tonë"
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	168	4	"...nën ndikimin e të cilëve truri i majmunëve u shëndrua në trurin e njeriut"
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	169	1	"Kjo ka kushtëzuar ndërrime të vogla ose të mëdha trupore dhe kështu me mutacione janë krijuar racat njerëzore"
Biologjia	12	Gjimnazi i Përgjithshëm, Matematikë dhe Informatikë	169	2	"Raca është kuptim biologjik dhe emëron (përcakton) grupin e individëve të të njejtë lloji, i cili nga grupet tjera dallohet me disa veçori të cilat trashëgohen, siç janë ngjyra e lekurës, e flokëve dhe e syve, forma e flokëve, e hundës, e buzëve etj."
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	9	4	"...përdori dhunë dhe me gjak e shtypi Komunën e Parisit"

Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	13	1	"Mbretëresha me modestinë e saj dhe me respekt për parlamentin e vendit, shpejt fitoi simpatinë e anglezëve"
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	36	1	"Kolonët e bardhë nuk e patën të vështirë të depërtonin në zonat e thella të Perëndimit të banuara nga indianët."
Historia		Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	46	2	"...ishite një sultan i egër dhe dinak."
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	55	1	"...shkaktoi gjithashtu terrori dhe shpërngulja me dhunë nga trojet e veta stërgjyshore dhjetra mijë familjeve shqiptare nga ushtritë serbe e malazeze."
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	83	2	"Konferenca copëtoi rëndë trojet etnike shqiptare duke realizuar pretendimet shoviniste të agresorëve ballkanikë"
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	119	1	"Ky shtet[Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene] kishte 12 milionë banorë, prej të cilëve 4 milion ishin serbë. Më shumë se gjysma e banorëve të këtij shteti, ishin: shqiptarë, boshnjakët, gjermanët, hungarezët etj."
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	195	3	"Ata në qershor e gusht të vitit 1944, torturuan, therën e vranë me mijëra burra, përdhunuan me qindra gra të reja"
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	202	1	"...akti burrëror i një minatori..."
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	205	4	"...futi në veprim një makineri të fuqishme ushtarako-politore e propagandistike, jo vetëm kundër njesiteve UÇK-së, por edhe kundër popullatës civile, rrjedhojë e të cilave janë skenat e liahtarshme të barbarisë së eskardroneve gjakatare, vrasjet e masakrimit e njerëzve të pafuqishëm e të pafajshëm(fëmijëve, grave, pleqve)..."
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	206	3	"...gjenocidit të egër..."
Historia	10	Gjimnazi Matematikë dhe Informatikë, Shkencat natyrore	207	1	"Vetëm gjatë mujave të bombardimit të NATO-s ushtria serbe vrau mbi 15.000 shqiptarë në mesin e të cilëve kishte edhe shumë fëmijë, gra e pleq."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	9	1	"Në shqyrtimet e veta shoqërore dhe politike, ai angazhohet për ruajtjen e institucionit të robërisë, duke konsideruar se robërit janë të domosdoshëm për jetë të njerëzve të "vërtetë", dhe me këtë nocion ai i nënkuptonte qytetarët e lirë."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	11	3	"Ndarja e shoqërisë në klasa është pasojë e mëkatit të parë njerëzor, por njëkohësisht është edhe nevojë e zhvillimit shoqëror, sepse e siguron edhe plotësimin më të mirë të nevojave të shoqërisë (ekonomike, politike, dhe shpirtërore)"
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	16	1	"Psh funksioni i hapur i arsimit qëndron në bartjen e dijes, ndërsa funksioni i tij latent është të rrisë dhe të ruajë barrierat klasore..."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	44	2	" Sipas Engelsit, në bashkësinë e parë primitive, goftë ajo "gens" (fis) i romakëve, ose qofshin ato fise lëkurë-kuqërremtë, vlen prona kolektive."

Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	51	1	"Organizata politike me shekuj ka qenë në kuptimin e plotë të fjalës objekt i çdo të menduari për jetë shoqërore të njeriut, për njeriun si kafshë shoqërore, ku ishte e kuptuar pa ndonjë ndryshim të kuptimit të sotëm të dyfishtë "shoqëria" dhe "politika"."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	53	4	"Ajo që për këta tre tipa të pushtetit është e përbashkët- është kontributi ruajtjen e shoqërisë së të pabarabartëve, të ndarë në të fuqishëm dhe dobët, në bazë të tipit të parë- në të pasur dhe të varfër, në bazë të tipit të dytë- në të arsimuar dhe të dijsëm dhe të paarsimuar dhe të padijshëm dhe në bazë të tipit të tretë- në të lartë dhe të ulët."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	75	2	"Brenda mekanizmit të tërësishëm të dhunës shoqërore, veprojnë mekanizmat që kanë rol të rëndësishëm ndërmjetësues. Këto janë familja, shkolla dhe kisha. Argumentet e tyre janë "Brenda mekanizmit të tërësishëm të dhunës shoqërore, veprojnë mekanizmat që kanë rol të rëndësishëm ndërmjetësues. Këto janë familja, shkolla dhe kisha. Argumentet e tyre janë bindja dhe indoktrinimi. Ato njerëzit i edukojnë ashtu që të pranojnë rendin shoqëror si të arsyeshëm dhe si të dobishëm."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	77	3	"Nga rebelimi i shuar studentor i viteve të 70-ta, lindi vala e rebelimit të gruas, lëvizja neofeministe."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	85	1	"E shenjtë mund të jetë çkadoqoftë (objekt, vend, kafshë, qenie), që konsiderohet e veçantë, jo e zakonshme, misterioze, madje edhe e rrezikshme- por që nxit ndjenjën e respektit dhe të frikës."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	89	4	"Ndarja e njerëzve në të varfër dhe të pasur prora arsyetohet përmes mjeteve të ndryshme ideologjike... në shoqërinë moderne kjo arsyetohet nga ideologjia komuniste me shfrytëzimin e të varfërve nga të pasurit.."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	100	6	"Kjo teori provon të japë përgjigje për faktorët e drejtpërdrejtë që ndikojnë në procesin e reprodukimit të popullsisë, siç janë popullsia që merret me bujqësi dhe veprimtari të tjera bujqësore, shkalla e arsimit të femrave, punësia e tyre etj."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	109	1	" Është e njohur se krahas pikëtakimeve që kanë fshati dhe qyteti, si dhe vendbanimeve të njerëzve, ato kanë edhe dallime madje edhe në vetë kuptimin e emrave të tyre: kur themi fshat dhe fshatar disi nënkuptojmë njerëz më larg mundësive kulturore.."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	113	2	"Përkundër shumë burimeve të cilat ofrojnë të dhëna shqetësuese për shtimin e shkurorëzimeve, për numrin gjithnjë më të madh të fëmijëve që lindin jashtë martesës, për pozitën e ndryshuar të gruas në shoqërinë bashkëkohore, familja edhe më tutje mbetet institucion qëndror."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	113	4	"Familja në aspektin përbajtësor, strukturor dhe formal është grup shoqëror i ndryshueshëm, veçoritë universale të së cilës janë: a) që mbështetet në lidhje heteroseksuale, në të cilën gratë dhe burrat plotësojnë nevojat seksuale, shpirtërore, morale dhe estetike dhe sigurojnë reprodukimin e shoqërisë me lindjen e pasardhësve.."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	114	1	"Familja krijohet me martesë mes burrit dhe gruas, në të cilën lindin fëmijët, dhe martesë si e tillë bëhet shtyllë strukturorë formale rreth së cilës kristalizohet bashkësia familjare."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	114	4	"Martesë qytetare- që egziston në shoqëritë moderne qytetare, ndërsa lidhet para organeve shtetërore dhe sanksionohet me norma juridike;"

Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	115	3	"Në shoqëritë bashkëkohore, megjithatë, disa familje mund t'i vlerësojmë si matriarkale- pas vdekjes së burrit apo shkurorëzimit, nëse fëmijët i përkasin nënës."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	120	2	"Epokën bashkëkohore, siç është e njohur, e karakterizojnë lëvizjet e gruas, të cilat parashtrajnë dhe dëshmojnë të drejtën natyrore për barazi me pjesën tjetër të njerëzimit, me burrat, edhe përkundër dallimeve natyrore ndërmjet tyre."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	120	3	"Fatkeqësia historike e gruas, si qenie njerëzore, deri sot është shpjeguar me faktin se ka jetuar në "shoqëri maskullore", në civilizim maskullor."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	122	5	"Në sistemin tonë ekzistojnë tri përshkrime themelore të pozitës sociale të gruas: 1) Pozita shoqërore e gruas është e ndryshme me pozitën shoqërore të burrit., 2) gruaja nuk është e barabartë me burrin; dhe 3) gratë u përkasin grupeve të shfrytëzuara, ndërsa shfrytëzues janë burrat, ose sistemi patriarkal i krijuar prej burrit."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	126	2	"Plegëri është ndarje nga shokët dhe kolegët, kërcënon me vdekjen e partnerit të jetës, kërcënon me lëvizje të kufizuara."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	126	Foto	"Pensionistët bëjnë jetë pasive."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	163	4	"Kosova është një vend i njohur për sukseset e boksierëve të saj, dhe kryesisht këta sportistë kanë lindur në familje me pozitë jo të mirë sociale."
Sociologjia	12, 13	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore, Gjimnazi i përgjithshëm	165	2	"Duke marrë parasysh karakterin individualist të shqiptarëve, që e theksojnë shumë sociologë të huaj, rezultatet më të mëdha shqiptarët i arrijnë në sportet individuale.."
Historia	12	Gjimnazi i përgjithshëm	40	3	"Ishte kjo një fitore e madhe e popullit grek ku ndihmesën e tyre dhanë edhe popujt e tjerë fqinjë, si shqiptarët etj."
Historia	12	Gjimnazi i përgjithshëm	52	3	"Që në vitin 1844, Greqia dhe Serbia kishin përpunuar programe të posaçme politike me karakter shovinist."
Historia	12	Gjimnazi i përgjithshëm	53	6	"Nëse hynin në luftë përkrah osmanëve, atëherë do të ndihmonin sunduesin e tyre shekullor dhe do të vihej në pikëpyetje qenia shqiptare."
Historia	12	Gjimnazi i përgjithshëm	127	3	"Në mars 1913, gjatë një vizite në Selanik, u vra mbreti Jorgo I, nga një person me çrregullime mendore."
Historia	12	Gjimnazi i përgjithshëm	145	4	"Kuvendi arriti të paralizonte qëndrimet e elementëve turkomanë, pjesëmarrës në Kuvend, të cilët kishin arritur të depërtonin aty."
Historia	12	Gjimnazi i përgjithshëm	154	4	"Edhe pse nuk u arrit të mbrohej tërësia e tokave shqiptare nga fqinjët grabitqarë, Shpallja e Pavarsisë ishte një fitore e madhe, jo vetëm kundër sundimit osman, por edhe kundër planeve shoviniste të shteteve fqinje ballkanike, të cilat synonin copëtimin e plotë të tokave shqiptare."
Historia	12	Gjimnazi i përgjithshëm	195	1	"Por gjithashtu u zhvilluar edhe portreti ku paraqitej figura e intelektualit apo bukuria femërore etj."
Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	41	1	"Luftërat e gjata dhe zbrazja nga ajka e shoqërisë i bëri shqiptarët më të brishtë dhe më të ndikueshëm."
Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	68	5	"Ky pushtet, shpeshherë, pronat shtetërore ua dhuronte personaliteteve me merita të veçanta si dhe anëtarëve të familjes së sultanit, si nënës, grave dhe motrave të tij."

Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	71	5	"Në oborrin e Ali Pashë Tepelenës në Janinë, për një kohë të qëndroi poeti anglez Xhorxh Bajron. Ky u afrua shumë me pashain shqiptar si dhe me shqiptarët në përgjithësi, të cilëve ua kushtoi veprën letrare."
Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	112	3	"...Partia Republikane (1854) që ishte kundër heqjes së skllavërisë."
Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	163	1	"Demokracia amerikane, kishe dy dobësi, qëndrimin ndaj indianëve autoktonë dhe ndaj ish skllavëve."
Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	167	1	"Prania e femrës në jetën shoqërore evidencohej gjithnjë e më shumë."
Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	190	1	"Në këtë Kuvend morën pjesë edhe elementë turkomanë, që u përpoqën që Kuvendi të shmangej nga qëllimi i organizimit të kryengritjes me pikësypnim autonominë e Shqipërisë."
Historia	11	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	201	3	"Ndjekjet, burgosjet, internimet, vrasjet, përdhunimet u bënë dukuri të përditshme"
Edukata Qytetare	10	Për të gjitha gjimnazet	40	2	"Disa grupe interesi janë të ndërtuara për të mbështetur një çështje të caktuar, si rezultat i bindjeve që ata kanë. P.sh, organizatat e grave synojnë mbrojtjen e të drejtave të grave dhe nxitjen e barazisë gjinore."
Edukata Qytetare	10	Për të gjitha gjimnazet	43	1	"Njerëzit që zgjedhin të punojnë për popullin në qeverisje janë shërbëtorët e tij, dhe jo padronë."
Edukata Qytetare	10	Për të gjitha gjimnazet	50	1	"Kryeministri i zgjedh ministrat në bazë të shumë faktorëve; talentit, aftësisë të punojnë si pjesë e ekipit, besnikërisë, frymës miqësore, gjatësisë në shërbim, popullaritetit dhe faktorëve gjeografikë."
Edukata Qytetare	10	Për të gjitha gjimnazet	72	3	"Kosova synon të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, i cili përfshin 25 vende me 450 milionë njerëz që flasin mbi 10 gjuhë të ndryshme zyrtare."
Edukata Qytetare	10	Për të gjitha gjimnazet	82	2	"Kosova është relativisht e paprekur nga ajri i papastër."
Edukata Qytetare	10	Për të gjitha gjimnazet	101	2	"Diskriminimi mbështetet mbi racën, kombësinë, origjinën etnike, gjininë, orientimin gjinor, statusin bashkëshortor, opinionin personal politik, fetar, mbi moshën, shëndetin ose kritere të tjera."
